



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA  
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS  
Strategji dhe teknika të komunikimit

**Ngarkesa:** 6 ETCS, 30leksione / 30 seminare

**Viti akademik:** 2024-2025, Viti II/sem I

**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme

**Programi i studimit:** Master i Shkencave në "Komunikim ndërkulturor dhe turistik trigjuhësh"

**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

**PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:**

Kursi Strategji dhe Teknika të Komunikimit është ndërtuar duke patur në vëmendje aftësitë komunikuese që dikton sot shoqëria.

Lënda përfshin leksione, seminare, punime hulumtuese të realizuara këto nëpërmjet formave të ndryshme sociale (punë individuale, në grup, diskutime etj.). Ajo është konceptuar në përputhje me metodat bashkëkohore, duke u përqendruar tek studenti dhe pjesëmarrja e tij aktive dhe ndërvepruese në procesin e mësimdhënies.

Krahas materialeve bazë, leksioneve të hartuara nga titullarët e lëndës, studentëve do t'u ofrohet literaturë mbështetëse që konsiston në materiale autentikë, audiovizive etj., të cilat do të ndihmojnë në plotësimin e kuadrit lëndor dhe do t'i mundësojnë studentëve përballjen me çështjet e larmishme të kësaj fushe dhe të përdorimit të tyre të përshtatshëm në punimet e tyre individuale.

Orët e praktikës do të shërbejnë për shkëmbime dhe ndërveprime të studentëve me njëri-tjetrin. Studentët do të sintetizojnë dhe aplikojnë njohuri dhe aftësi të fituara më parë gjatë studimeve për të dëshmuar kompetencë në këtë fushë.

Kursi ofron njohuri dhe ekspertizë për strategjitë dhe teknikat për një komunikim të arrirë, si edhe në organizimin dhe përshtatjen e mesazheve në varësi të konteksteve të ndryshme.

Ai synon që studentët të realizojnë aftësitë komunikuese në grup, skuadër, të hartojnë raporte biznesi, propozime, letra etj. në kontekst organizate, institucioni, biznesi e të tjera si këto.

Kursi ofron gjithashtu njohuri të thelluara të praktikave komunikative si menaxhimin e krizave, komunikimin në institucion dhe etikën e komunikimit.